



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 462 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

VENDIM Nr. 88 datë 18.03.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor – shkencor të ri*, vëzhgime sipërfaqësore në kuadër të shkollës doktrale nga Fakulteti i Histori – Filologjisë, Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Bolonjës, me temë *"Vendbanime të fortifikuara kodrinore – malore në territorin e Tiranës (Shqipëri)"*, midis periudhave klasike dhe helenistike, doktorante Znj. Mirela Koçollari, me udheheqës Prof. Dr. Lorenc Bejko.

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor – shkencor të ri*, vëzhgime sipërfaqësore në kuadër të shkollës doktrale nga Fakulteti i Histori – Filologjisë, Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Bolonjës, me temë *"Vendbanime të fortifikuara kodrinore – malore në territorin e Tiranës (Shqipëri)"*, midis periudhave klasike dhe helenistike, doktorante Znj. Mirela Koçollari, me udheheqës Prof. Dr. Lorenc Bejko, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vëzhgime arkeologjike në sipërfaqe (Survey) për të përditësuar dokumentacionin fotografik dhe për të verifikuar gjendjen e ruajtjes të siteve të njohura, por edhe për të ballafaquar nëse ekzistojnë site analoge në rrethinat e Tiranës. Në rastin e Persqopit dhe Dorëzit gjithashtu është planifikuar të bëhet një rishikim sistematik për të vlerësuar programin e ardhshëm për çdo sondazh të mundshëm.
 - Redaktimi i një dokumentacioni të ri topografik të përditësuar të siteve arkeologjike të Persqopit dhe Dorëzit me përdorim të metodologjisë kërkimore moderne si skaner 3D dhe Dron. Gjetjet e reja do të vihen në dispozicion të Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë, në mënyrë që të krijojnë në të ardhmen një hartë të rrezeve të mundshme statike dhe degraduese.
 - Analizë e thelluar dhe dokumentim i përpiktë i siteve arkeologjike të Persqopit dhe Dorëzit, si për qëllime kërkimore, ashtu edhe për mbrojtje dhe vlerësim.
 - Hartimi i një harte arkeologjike kompjuterike (GIS) të territorit të Tiranës në baza bibliografike, që të vihen në dispozicion të studiuesve por edhe organeve përgjegjëse për mbrojtjen dhe qeverisjen e territorit.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.

3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTRI



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO